



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 3880 prot.

Shkodër, me 18.2.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin: Për miratimin e shtesës së planit në buxhetin e bashkisë shkodër, të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025, 'për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor 2026-2028', si dhe për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të fondeve të akorduara të grantit të bazuar në performancë për vitin 2025.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Bener Beci





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____._____.2026

RELACION

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË PLANIT NË BUXHETIN E BASHKISË
SHKODËR, TË MIRATUAR ME VKB NR. 84, DATË 18.12.2025, 'PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR 2026-
2028', SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E DESTINACIONIT TË PËRDORIMIT TË
FONDEVE TË AKORDUARA TË GRANTIT TË BAZUAR NË
PERFORMANCË PËR VITIN 2025.**

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër ka aplikuar në thirrjen e shpallur për Fondin i Grantit të Bazuar në Performancë për vitin 2025.

Granti i Bazuar në Performancë është një formë financimi shtesë për bashkitë në Shqipëri, e cila jepet në mënyrë konkurruese në varësi të përmbushjes së një grupi treguesish të matshëm të performancës. Bazë dhënies së grantit është Sistemi i Matjes së Performancës (SMP), i cili vlerëson bashkitë mbi baza objektive dhe të krahasueshme.

Granti është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe dy donatorëve ndërkombëtarë: Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA). Procesi është koordinuar nga Agjencia për vetëqeverisjen vendore AMVV, duke siguruar dy burime financimi të brendshëm dhe të huaj.

Fondet e financimit të huaj për Grantin e Bazuar në Performancë përfitohen në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, mbi bazën e marrëveshjes përkatëse midis Qeverisë së Zvicres dhe asaj Shqiptare dhe menaxhohen bazuar në *Udhëzimin nr.10 datë 12.07.2024 "Per regjistrimin, perdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombetare"*, sipas skemës me thesar të plotë.

Bashkia Shkodër i është përgjigjur kësaj thirrje duke dorëzuar dokumentacionin përkatës brenda afateve të përcaktuara, për periudhën 1 janar - 17 Shtator 2025. Në përfundim të procesit të vlerësimit, Ministria e Financave shpërndan fondin të bashkitë përfituese pas

marrjes së njoftimit mbi Vendimin e marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve. Ky grant shpërndahet në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër është njoftuar nga Ministria e Financave, nëpërmjet shkresës nr. prot. 18133/1, datë 24.12.2025, për përfitimin e grantit të bazuar në performancë me burim financimi Buxhetin e Shtetit, në vlerën **1,258,426.97 lekë**. Ndërkohë, referuar procesverbalit të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, granti i bazuar në performancë me burim financimi të huaj do të jetë në vlerën **1,555,530.46 lekë**.

Për grantin e bazuar në performancë me burim financimi nga financimi i huaj, detajimi i fondit do të kryhet në momentin e marrjes së vendimeve nga Këshilli Bashkiak, për destinacionin e përdorimit të tij, në përputhje me Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr. 1031/5, datë 11.07.2025 dhe nr. nr. 10725, datë 11.07.2025 "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025". ***Në këtë udhëzues përcaktohet se Bashkitë kanë pavarësi të plotë të destinacionit të përdorimit të këtij fondi, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblime.***

Në këtë kuadër, për përdorimin e Fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për vitin 2025, Bashkia Shkodër ka planifikuar të përdorë:

Përshkrimi	Shuma (Lekë)	Artikulli
Shuma (burim financimi buxheti i shtetit)	1,258,426.97	231 - Shpenzime kapitale të trupëzuara
Shuma (burim financimi i huaj)	1,555,530.46	
Totali	2,813,957.43	

Këto fonde do të transferohen me destinacion programin buxhetor me destinacion programin buxhetor **AC141 Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural** për financimin e fsh projektit *P.AC141.Q3.O1.A15. Shkodra Digjitale: Harta Inteligjente për Turistët (Digital Shkodra: Smart Tourist Maps)*, në vlerën 2,813,957.43 lekë, artikull 231 - Shpenzime kapitale të trupëzuara, Institucioni Bashkia Shkodër, sipas fishes bashkëlidhur.

Në kushtet e zhvillimit të vazhdueshëm të turizmit, territori i Bashkisë Shkodër vizitohet çdo vit nga një numër në rritje turistësh të huaj, duke rritur ndjeshëm nevojën për ofrimin e shërbimeve cilësore të informacionit turistik. Bashkia Shkodër disponon zyrën e informacionit turistik pranë Sheshit "Demokracia", një godinë që mirëpret mesatarisht rreth 17,000 vizitorë në vit dhe që aktualisht ndodhet në proces rikonstruksioni.

Shkodra po e ndërton imazhin e saj si një destinacion i qëndrueshëm, autentik dhe mikpritës, ku natyra, historia dhe kultura bashkohen në mënyrë harmonike. Qyteti ndodhet në një moment kyç rritjeje, dhe detyra jonë është ta zhvillojmë këtë potencial me kujdes dhe vizion, duke siguruar që zhvillimi ekonomik të ecë paralelisht me ruajtjen e identitetit dhe trashëgimisë së pasur të Shkodrës. Në këtë kuadër, dhe duke u përshtatur me ritmet e rritjes së teknologjisë dhe nevojat e turizmit modern, është e nevojshme të vendosen tre harta digjitale interaktive (ekrane me prekje): një në Shkodër, një në Shirokë dhe një në

Theth. Këto pika informacioni do t'u mundësojnë turistëve të shohin hartën e zonës ku ndodhen, si dhe të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, të pasuruar me pikat kryesore turistike, kulturore, natyrore dhe shërbimet relevante.

Informacioni do të ofrohet në dy gjuhë, duke e bërë më të aksesueshëm për vizitorët vendas dhe të huaj, dhe duke përmirësuar ndjeshëm përvojën turistike në territorin e Shkodrës.

Për këtë arsye, vendosja e ketyre 3 info point-ve (tre harta digjitale interaktive (ekrane me prekje) lidhet drejtpërdrejt me rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, përmirësimin e përvojës së vizitorëve dhe forcimin e imazhit të qytetit, duke u përputhur plotësisht me objektivat e Grantit të Bazuar në Performancë për rritjen e efikasitetit dhe performancës së administratës lokale.

Sa më sipër, kërkohet miratimi i shtesës së planit në buxhetin e bashkisë shkodër, të miratuar me VKB nr.84, datë 18.12.2025 'Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor 2026-2028', si dhe për përcaktimin e destinacionit dhe qëllimit të përdorimit të fondeve të akorduara të grantit të bazuar në performancë për vitin 2025.

KRYETAR

Benet BECI

Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik

Behim Reme

Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirërimit të Klimës së Biznesit

Stela Mardulica

Drejtorja e Turizmit

Renato Luongo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. _____ prot.

Shkodër, me _____.2026

PROJEKT-VENDIMI

Nr. _____, datë _____.2026

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË PLANIT NË BUXHETIN E BASHKISË
SHKODËR, TË MIRATUAR ME VKB NR. 84, DATË 18.12.2025, 'PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026 DHE PROGRAMIT BUXHETOR 2026-
2028', SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E DESTINACIONIT TË PËRDORIMIT TË
FONDEVE TË AKORDUARA TË GRANTIT TË BAZUAR NË
PERFORMANCË PËR VITIN 2025.**

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot me datë _____.2026 në mbështetje të nenit 35, pika 1, germa "d", neni 54 germa 'dh' të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; të nenit 20, pika 1 dhe 5, ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; ligjit nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026"; ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksit 9 "Granti i Performancës për bashkitë"; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr 02, datë 14.01.2026 " Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor nr.1031/5, datë 11.07.2025 dhe nr.10725, datë 11.07.2025 "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025"; VKB nr.84, datë 18.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor 2026-2028"; shkresës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr.764 Prot., datë 19.12.2025, e cila përcjell vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve në kuadër të GBP 2025, shkresës së Ministrisë së Financave nr.prot. 18133/1, datë 24.12.2025, për përfitimin e grantit të bazuar në performancë me burim financimi Buxhetin e Shtetit, pas shqyrtimit të relacionit nr. _____ prot., datë _____, të administratës së Bashkisë Shkodër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesën e planit në buxhetin e bashkisë shkodër, të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor 2026-2028", për grantin me burim financimi Buxhetin e Shtetit, në vlerën **1,258,426.97 lekë**, dhe grantin me burim financimi të huaj, në vlerën **1,555,530.46 lekë**, sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr.prot. 18133/1, datë 24.12.2025.
2. Fondi do të kalojë në programin buxhetor **AC141 Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural** për financimin e fish projektit *P.AC141.Q3.O1.A15. Shkodra*

Digjitale: Harta Inteligjente për Turistët (Digital Shkodra: Smart Tourist Maps), për grantin me burim financimi buxhetin e shtetit në vlerën 1,258,426.97 lekë, dhe grantin me burim financimi të huaj, në vlerën 1,555,530.46, në shumën totale 2,813,957.43 lekë, Artikulli 231 - Shpenzime kapitale të trupëzuara, institucioni Bashkia Shkodër, sipas fishes bashkëlidhur.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR



Zy Kryetar

*Drejtorja e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse*

*Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar*

*Drejtorja e Analizës dhe Programimit
Buxhetor*

Drejtorja e Financës

Drejtorja Juridike

*Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të
Qendrueshëm Ekonomik*

*Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit*

Drejtorja e Turizmit

Nr.	P.AC141.Q3.O1.A15. Shkodra Digjitale: Harta Inteligjente për Turistët (Digital Shkodra: Smart Tourist Maps)		AC141 Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural																																																																																				
a) Përshkrim i shkurtër i projektit:																																																																																							
i. Situata Bashkia Shkodër ka aplikuar dhe është përzgjedhur për të përfituar Grantin e Bazuar në Performancë për vitin 2025, një formë financimi shtesë që jepet në bazë të rezultateve të matshme të performancës së bashkive. Ky grant, i financuar nga Buxheti i Shtetit dhe donatorë ndërkombëtarë (SDC dhe SIDA), ka për qëllim të mbështesë bashkitë në përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e efikasitetit të administratës lokale. Shkodra, si një nga bashkitë përfitues, ka një fond të përgjithshëm prej rreth 2,813,957.43 lekë (grant burim financimi Buxhetin e Shtetit, në vlerën 1,258,426.97 lekë, dhe grant me burim financimi të huaj, në vlerën 1,555,530.46 lekë), e cila do të ketë si destinacion realizimin e Hartave Digjitale për Turistët. Sot mund të themi me siguri se Shkodra po e ndërton imazhin e saj si një destinacion i qëndrueshëm, autentik dhe mikpritës, ku natyra, historia dhe kultura bashkohen në mënyrë harmonike. Qyteti ndodhet në një moment të rëndësishëm rritjeje, dhe detyra jonë është ta zhvillojmë këtë potencial me kujdes dhe vizion, duke siguruar që zhvillimi ekonomik të ecë paralelisht me ruajtjen e identitetit dhe trashëgimisë së pasur të Shkodrës. Në këtë kuadër, dhe duke u përshtatur me ritmet e rritjes së teknologjisë dhe nevojat e turizmit modern, është e nevojshme të vendosen tre harta digjitale interaktive (ekrane me prekje): një në Shkodër, një në Shirokë dhe një në Theth. Këto pika informacioni do t'u mundësojnë turistëve të shohin hartën e zonës ku ndodhen, si dhe të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, të pasuruar me pikat kryesore turistike, kulturore, natyrore dhe shërbimet relevante. Informacioni do të ofrohet në dy gjuhë, duke e bërë më të aksesueshëm për vizitorët vendas dhe të huaj, dhe duke përmirësuar ndjeshëm përvojën turistike në territorin e Shkodrës. ii. Synimi i projektit Me këtë projekt synojmë të përmirësojmë orientimin dhe informimin e turistëve në Bashkinë Shkodër përmes hartave digjitale interaktive, duke promovuar atraksionet kryesore dhe duke forcuar imazhin e Shkodrës si një destinacion modern dhe të qëndrueshëm. iii. Aktivitetet kryesore të projektit 1. Projektimi dhe zhvillimi i hartave digjitale interaktive 2. Instalimi i 3 ekraneve me prekje në Shkodër, Shirokë dhe Theth 3. Përgatitja e përmbajtjes turistike (pika kulturore, natyrore, shërbime) 4. Përkthimi i informacionit në dy gjuhë 5. Testimi, trajnimi i përdorimit dhe vënia në funksion e sistemit b) Rezultatet që prisni 1. Përmirësim i orientimit dhe përvojës së turistëve 2. Rritje e vizitave në atraksionet kryesore 3. Informim më i shpejtë dhe më i aksesueshëm për vizitorët 4. Forcimi i imazhit të Shkodrës si destinacion modern. <table border="1"> <tr> <td colspan="2">c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</td> <td colspan="6">d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)</td> </tr> <tr> <td colspan="2">Bashkia Shkodër</td> <td colspan="6">Programet e BE-së Media dhe organizata kulturore, biznese turistike, Donator të tjerë</td> </tr> </table> e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii) (në lekë) <table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="2"></th> <th colspan="5">Nga kjo</th> <th></th> </tr> <tr> <th colspan="2"></th> <th></th> <th>Paga</th> <th>Sigurime</th> <th>Operative</th> <th>Transferime</th> <th>Kapitale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A.1</td> <td>Furnizim vendosje e tabelave informuese (digjitale)</td> <td>2,813,957.43</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>2,813,957.43</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Shuma (Buxheti i shtetit + me burim financimi i huaj)</td> <td>2,813,957.43</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>2,813,957.43</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Shuma (burim financimi buxheti i shtetit)</td> <td>1,258,426.97</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>1,258,426.97</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Shuma (burim financimi i huaj)</td> <td>1,555,530.46</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>1,555,530.46</td> </tr> </tbody> </table> <table border="1"> <tr> <td colspan="2">f) Periodua e zbatimit 2026</td> <td colspan="6">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Turizmit,</td> </tr> <tr> <td colspan="2">Viti 2026</td> <td colspan="6">Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër</td> </tr> </table>								c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)		d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)						Bashkia Shkodër		Programet e BE-së Media dhe organizata kulturore, biznese turistike, Donator të tjerë								Nga kjo									Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale	A.1	Furnizim vendosje e tabelave informuese (digjitale)	2,813,957.43					2,813,957.43		Shuma (Buxheti i shtetit + me burim financimi i huaj)	2,813,957.43					2,813,957.43		Shuma (burim financimi buxheti i shtetit)	1,258,426.97					1,258,426.97		Shuma (burim financimi i huaj)	1,555,530.46					1,555,530.46	f) Periodua e zbatimit 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Turizmit,						Viti 2026		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër					
c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)		d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)																																																																																					
Bashkia Shkodër		Programet e BE-së Media dhe organizata kulturore, biznese turistike, Donator të tjerë																																																																																					
		Nga kjo																																																																																					
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale																																																																																
A.1	Furnizim vendosje e tabelave informuese (digjitale)	2,813,957.43					2,813,957.43																																																																																
	Shuma (Buxheti i shtetit + me burim financimi i huaj)	2,813,957.43					2,813,957.43																																																																																
	Shuma (burim financimi buxheti i shtetit)	1,258,426.97					1,258,426.97																																																																																
	Shuma (burim financimi i huaj)	1,555,530.46					1,555,530.46																																																																																
f) Periodua e zbatimit 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Turizmit,																																																																																					
Viti 2026		Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër																																																																																					